



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 88/6 prot

Datë 09.02.2024

V E N D I M

Nr. 163/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.02.2024 me,

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “BESIM KAMBERI” PF në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr.REF-89010-11-24-2023, me objekt: “*Blerje detergjent për rezervat materiale të Shtetit*” me fond limit 4,040,943 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 11.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

Autoriteti Kontraktor:

Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara me adresë: Blv ”Dëshmorët e Kombit”, Nd.1, 1001, Tiranë.

Ankimues:

“BESIM KAMBERI” PF, me NUIS L42103023G, me adresë: Rruga e Qelqit , Zona Kadastrale Nr 3866 Nr. Pasurie 310/20 - Kashar 1001, Tiranë.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e*

Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlëra limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 30.11.2023, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-89010-11-24-2023, me objekt: “Blerje detergjent për rezervat materiale të Shtetit” me fond limit 4,040,943 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 11.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 27.12.2023, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, janë njoftuar elektronikisht për vlerësimin e ofertave si më poshtë vijon:

“Anbim” SHPK	2.846.625 lekë, skualifikuar
“Murati D” SHPK	2.846.625 lekë, skualifikuar
“Egian Med” SHPK	2.937.717 lekë, skualifikuar
“Besim Kamberi” PF	3.302.085 lekë, skualifikuar
“Atlantik 3” SHPK	3.415.950 lekë, skualifikuar

Operatori ekonomik “Besim Kamberi” PF, rezulton i skualifikuar me argumentet e mëposhtme:

Arsyet e skualifikimit:

Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 1, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” i Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 19% e vlerës së fondit limit.”

II.3. Në datën 10.01.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e anulimit të procedurës së prokurimit në SPE.

II.4. Në datën 15.01.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 88/2024 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3752 e operatorit ekonomik “BESIM KAMBERI” PF për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-89010-11-24-2023, me objekt: “Blerje detergjent për rezervat materiale të Shtetit” me fond limit 4,040,943 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 11.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “BESIM KAMBERI” PF.

Konkretisht pretendohet si vijon:

“Shoqëria jonë për plotësimin e kriterit në pikën 1, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” i Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, ka dorëzuar në SPE dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Faturë elektronike e fiskalizuar me Nr. 62/2022, datë 19.10.2022, Klienti : BASHKIA KORCE me vlerë 125 000 lekë pa tvsh.

2. Faturë elektronike e fiskalizuar me Nr. 10/2023, datë 24.02.2023, Klienti : SPITALI PSIKIATRIK me vlerë 250 050 lekë pa tvsh.

3. Faturë elektronike e fiskalizuar me Nr. 38/2022, datë 26.07.2022, Klienti : OPERATORI SISTEMIT TRANSMETIMIT OST me vlerë 315 000 lekë pa tvsh.

4. Dokumentin “Fatura privat (843417) ku gjenden fatura të lëshuara nga ana jonë për sektorin privat, me vlerë 843 417 lekë pa tvsh.

Referuar kriterit në pikën 1, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” i Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 19% e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Dokumentacioni i paraqitur nga ana jonë sa i takon vlerës 19% të fondit limit është në vlerën totale 1 533 467 lekë pa tvsh. Pra, nga ana e autoritetit kontraktor kërkohet që vlera totale pa tvsh të jetë në masën 767 779,17 lekë, ndërkohë që ne kemi dorëzuar 2-fishin e vlerës. Praktikisht në arsyen e skualifikimit tonë nuk është vlera e cila nuk plotësohet.

Nga shqyrtimi i datave të dokumentacionit (fatura) rezulton se janë të gjitha të 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Praktikisht në arsyen e skualifikimit tonë nuk është data e dokumentave e cila nuk plotësohet.

Në logjikën e autoritetit kontraktor mbetet që produktet e tregtuara nga ana jonë nuk janë të ngjashme me objektin e prokurimit.

Objekti i prokurimit është “BLERJE DETERGJENT PER REZERVAT MATERIALE TE SHTETIT” dhe cdo faturë e paraqitur nga ana jonë ka lidhje të drejtëpërdrejtë me objektin e prokurimit dhe nuk mund të mos merren si të ngjashme.

Fryma e ligjit sa i takon kriterit të sipërcituar është që autoriteti kontraktor të njohë historikun dhe fushën e veprimtarisë e shtrirë në 3 vite të zhvilluar nga operatori ekonomik mbi objektin e prokurimit. Në thelb të ngjashme nuk do të thotë që të jenë të njëjta por t’i përkasin një fushe të caktuar.”

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot. 88/2, datë 16.01.2024, me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “BESIM KAMBERI” PF, kundërshton me anë të ankesës me nr. 88 prot., datë 15.01.2024.

II.6. Në datën 24.01.2024, është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 88/3 prot., shkresa e autoritetit kontraktor 73/4 prot., datë 22.01.2024, me objekt: “Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje detergjent për rezervat materiale të Shtetit””, drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik, bashkëngjitur procesverbali për hapjen publike të ofertave të dorëzuara, datë 11.12.2023; procesverbali i datës 18.12.2023 “Për shqyrtimin dhe rivlerësimin e ofertave” për procedurën e mësipërme të prokurimit; ankesa e operatorit ekonomik “Besim Kamberi” PF; Urdhërin e pezullimit; Vendimi i KSHA-së; CD.

Referuar vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave “Mbi shqyrtimin e ankesës së ankimuesit “Besim Kamberi” PF” rezulton, se autoriteti kontraktor ka vendosur refuzimin e ankesës së operatorit ekonomik “Besim Kamberi” PF, pa dhënë asnjë argument apo gjykim mbi pretendimet e ankimuesit.

II.7. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime

nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “BESIM KAMBERI” PF se: “Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 1, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” i Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 19% e vlerës së fondit limit”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1 Në shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit, “Kriteret e veçanta të kualifikimit” “Kapaciteti teknik” pika 2.3.1. është parashikuar kriteri si më poshtë:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 19% e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. *Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*
- b. *Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

III.1.2. Në shtojcën 6 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit”, të dokumenteve të tenderit të publikuara në SPE, rezulton, se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar si vijon:

Lista e Çmimeve

BLERJE DETERGJENT – REZERVAT MATERIALE TE					
SHTETIT					
Nr.	Emërtimi i artikujve ushqimorë	Njësia matëse	Çmimi për njësi (LEKË PA TVSH)	Sasi të pritshme	Vlera (LEKË PA TVSH)
1	Pluhur larës për rroba larje me dorë				
1.1	Pluhur larës për rroba larje me dorë (ambalazh qese plastike)	Kg		22,773	

Afatet e lëvrimit: 20 (njëzet) ditë nga lidhja e kontrates

III.1.3. Vlera e fondit limit të procedurës së mësipërme të prokurimit është 4,040,943 lekë pa TVSH. Autoriteti kontraktor ka parashikuar eksperiencën të mëparshme për tre vitet e fundit në një vlerë jo më të vogël se 19% e fondit limit, ose në një vlerë jo më të vogël se **767.779 lekë** pa TVSH.

III.1.4. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik, në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Besim Kamberi” PF, ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

a. Faturë elektronike me Nr. 38/2022, datë 26.07.2022, me blerës Operatorin e Sistemit të Transmetimit, OST me vlerë 315 000 lekë pa tvsh. Kjo faturë, në përshkrimin e mallit ka artikujt: Acid, amoniak, bishta fshese, dorëza pastrimi, kova plastike dhe shtrydhëse, lecka pastrimi, letër higjenike, pastrues xhamash, peceta pastrimi, shtupa dysHEMEJE, solucion larje duarsh, solucion larje dysHEMEJE, solucion larje enesh, sapun duarsh, solucion wc, tel enesh, sfungjer enesh, thasë plehrash.

b. Faturë elektronike me Nr. 62/2022, datë 19.10.2022, me blerës Bashkinë Korçë, me vlerë 125 000 lekë pa tvsh. Kjo faturë, në përshkrimin e mallit ka artikujt: sgrasatore, lares enesh, dizifektues tualeti, klor, sfungjer enesh, sfungjer trupi, lopate plehrash, bisht dhe fshese, furce tualeti, fshese, kova, bishta fshese, shtupe pastrimi, peceta mikrofiber, leres dysHEMEJE, lares xhamash, qese mbeturinash, sapun i lengshem, leter higjenike, acid, letar te lagura, paste dhembesh, pluhur lares rrobash, sapun duarsh, shampo koke, shampo për parazitë, shampo për fëmijë, paste dhembesh për fëmijë, furce dhembesh për fëmijë, detergjent i lengshem rroba, ace, doreza pastrimi.

c. Faturë elektronike me Nr. 10/2023, datë 24.02.2023, me blerës Spitalin Psikiatrik Elbasan me vlerë 250 050 lekë pa TVSh. Kjo faturë, në përshkrimin e mallit ka 12 artikuj si vijon: solucion larës dysHEMEJE, solucion larje xhamash, shampo për parazitë, shampo koke, shampo trupi, sapun rrobash, sapun duarsh, acid për pastrim, saolucion larës dhe dizifektues wc, anti kalkare për hidrosanitare, solucion kunder mizave, klor pluhur.

d. 10 (dhjetë) Fatura tatimore me shitës shoqërinë ankimuese për sektorin privat, me vlerë 843 417 lekë pa TVSh. Konkretisht:

1. Fatura tatimore me blerës Bes-T Capital Invest, në përshkrim e mallit ka artikujt: likuid duarsh, ilac xhami, ilac pllakash, pulirapid, sgrasatore, ace, doreza, fshese, qese mbeturinash, leter higjenike, sfungjer enesh, shtupe mikrofiber.
2. Fatura tatimore me blerës kompaninë Joena, në përshkrim e mallit ka artikujt: alkool desinfektues dy lloj.
3. Fatura tatimore me blerës kompaninë Kovaçi-AF, në përshkrim e mallit ka artikujt: ace zbardhues, zbardhues blu, acid muratik.
4. Fatura tatimore me blerës D.Dibra, në përshkrim e mallit ka artikujt: aromatizues, leter e lagur, kartopeceta, zhblokues lavamani, peceta mikrofiber, sapun duarsh, kove me veteshtrydhje, kaci dhe bisht, kosha metalik zyre, maska njeperdorimshe, aparat aromatizues ambineti, aparat leter duarsh.

5. Fatura tatimore me blerës D.Dibra, në përshkrim e mallit ka artikujt: mastrolindo wc, fshesa pastrimi dhe bisht, sfungjer enesh, ilac xhami, qese plehrash te zeza, qese mbeturinash e mesme, furca tualeti, leter higjenike, sgrasatore purus.
6. Fatura tatimore me blerës kompaninë Bes-T Capital Invest, në përshkrim e mallit ka artikujt: pluhur lavatrice rroba të bardha, pluhur larës rroba me ngjyrë, acid muratik, likuid duarsh, ilac xhami, sgrasatore, likuid duarsh.
7. Fatura tatimore me blerës kompaninë Bes-T Capital Invest, në përshkrim e mallit ka artikujt: antikalkare, kapse porte, leter higjenike, kosha rrobash, aromatizues ambienti, aparat aromatizues ambienti, bombul aparati, doreza pastrimi, pulirapid, fshesa pastrimi dhe bisht, kova pastrimi, qese mbeturinash 3 lloje, leter duarsh rulon.
8. Fatura tatimore me blerës K.Çipi, në përshkrim e mallit ka artikujt: acid, zbardhues blu, ilac xhami, sgrasatore, xhel dezinfektues, alkool dezinfektues.
9. Fatura tatimore me blerës kompaninë Nirupa, në përshkrim e mallit ka vetëm artikullin klor rifuxho.
10. Fatura tatimore me blerës A.Rexhmati, në përshkrim e mallit ka artikujt: ace, acid, lavapiati purus.

III.1.5. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë eficiencyn dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 8 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

III.1.6. Në nenin 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë*

proporcionale me objektin e kontratës.”. 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim. 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. 9 Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.7. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 4, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre vjetëve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara

nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”.

III.1.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.9. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Besim Kamberi” PF, në përmbushje të kriterit për përvojat e mëparshme, KPP vlerëson se së pari, norma juridike duhet të interpretohet e më pas të gjykohet, kjo për të analizuar në thelb ratio legis, kuptimin e drejtë të saj. Kështu, ligjvënësi ka parashikuar diskrecionin e autoritetit kontraktor të kërkimit të dëshmi për përvojën e mëparshme, me synim për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Pra e drejta e dhënë nga ligji lidhet ngushtësisht me garantimin e autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik disponon dëshmi të përvojës së mëparshme për të realizuar kontratën sipas kërkesave të dokumenteve të tenderit. Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për mallra ligjvënësi në nenin 40, pika 4 të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ka parashikuar, se ky kriter në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me entet publike, mund të përmbushet me dorëzimin e vërtetimeve të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, dhe në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin

privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasishtë e mallrave të furnizuara. Gjithashtu, në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar se plotësimi i njërit prej dy kushteve e bën ofertën të kualifikueshme.

KPP konstaton, se në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 të Shtojcës 7 të dokumentave të tenderit të sipërpërmendur, autoriteti kontraktor ka përcaktuar, që *operatori ekonomik duhet të paraqesë duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 19% e vlerës së fondit limit. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasishtë e mallrave të furnizuara. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasishtë e mallrave të furnizuara.*

Në përmbushje të kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.1 të Shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit të sipërpërmendur, operatori ekonomik “Besim Kamberi” PF ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik faturë elektronike me Nr. 38/2022, datë 26.07.2022, me blerës Operatorin e Sistemit të Transmetimit, OST me vlerë 315 000 lekë pa TVSh, që përmban zërat acid, amoniak, bishta fshese, dorëza pastrimi, kova plastike dhe shtrydhësa, lecka pastrimi, letër higjenike, pastrues xhamash, peceta pastrimi, shtupa dysHEMEJE, solucion larje duarsh, solucion larje dysHEMEJE, solucion larje enesh, sapun duarsh, solucion wc, tel enesh, sfungjer enesh, thase plehrash; faturë elektronike me Nr. 62/2022, datë 19.10.2022, me blerës Bashkinë Korçë, me vlerë 125 000 lekë pa TVSh, me zërat sgrasatore, lares enesh, dizifektues tualeti, klor, sfungjer enesh, sfungjer trupi, lopate plehrash bisht dhe fshese, furce tualeti, fshese, kova, bishta fshese, shtupe pastrimi, peceta mikrofiber, leres dysHEMEJE, lares xhamash, qese mbeturinash, sapun i lengshem, leter higjenike, acid, letar te lagura, paste dhembesh, pluhur lares rrobash, sapun duarsh, shampo koke, shampo për parazite, shampo për fëmijë, paste dhembesh per femije, furce dhembesh për femijë, detergjent i lengshem rroba, ace, doreza pastrimi; faturë elektronike me Nr. 10/2023, datë 24.02.2023, me blerës Spitalin Psikiatrik Elbasan me vlerë 250 050 lekë pa TVSh me zërat: solucion larës dysHEMEJE, solucion larje xhamash, shampo për parazitë, shampo koke, shampo trupi, sapun rrobash, sapun duarsh, acid për pastrim, saolucion larës dhe dizifektues wc, antikalkare per hidrosanitare, solucion kunder mizave, klor pluhur. Gjithashtu, ka paraqitur 10 (dhjetë) fatura me vlerë në total 843 417 lekë pa TVSh dhe konkretisht: fatura tatimore me blerës Bes-T Capital Invest, me zërat likuid duarsh, ilac xhami, ilac pllakash, pulirapid, sgrasatore, ace, doreza, fshese, qese mbeturinash, leter higjenike, sfungjer enesh, shtupe mikrofiber; fatura tatimore me blerës kompaninë Joena, me zërat: aklol desinfektues dy lloj; fatura tatimore me blerës kompaninë Kovaçi-AF, me zërat: ace zbardhues, zbardhues blu, acid muratik; faturë tatimore me blerës D.Dibra, me zërat: aromatizues, leter e lagur, kartopeceta, zhbllokues lavamani, peceta mikrofiber, sapun duarsh, kove me veteshtrydhje, kaci dhe bisht, kosha metalik zyre, maska njëpërdorimshe, aparat aromatizues ambineti, aparat leter duarsh; faturë tatimore me blerës D.Dibra, me zërat:

mastrolindo wc, fshesa pastrimi dhe bisht, sfunxher enesh, ilac xhami, qese plehrash te zeza, qese mbeturinash mesme, furca tualeti, leter higjenike, sgrasatore purus; faturë tatimore me blerës kompaninë Bes-T Capital Invest, me artikujt: pluhur lavatrice rroba të bardha, pluhur larës rroba me ngjyrë, acid muratik, likuid duarsh, ilac xhami, sgrasatore, likuid duarsh; faturë tatimore me blerës kompaninë Bes-T Capital Invest, me artikujt: antikalkare, kapse porte, leter higjenike, kosha rrobash, aromatizues ambienti, aparat aromatizues ambienti, bombul aparati, doreza pastrimi, pulirapid, fshesa pastrimi dhe bisht, kova pastrimi, qese mbeturinash 3 lloje, leyter duarsh rulon; fatura tatimore me blerës K.Çipi, me artikujt: acid, zbardhues blu, ilac xhami, sgrasatore, xhel dezinfektues, alkool dezinfektues; faturë tatimore me blerës kompaninë Nirupa, me artikullin klor rifuxho; faturë tatimore me blerës A.Rexhmati, me artikujt: ace, acid, lavapiati purus.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Besim Kamberi” PF, KPP konstaton, se nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të këtyre faturave, duke nisur nga përshkrimi i mallit të faturave elektronike, rezulton, se ato nuk janë të ngjashme me objektin e prokurimit në shumicën e artikujve. Konkretisht nuk janë të ngjashme zërat acid, amoniak, bishta fshese, dorëza pastrimi, kova plastike dhe shtrydhëse, leckë pastrimi, letër higjenike, pastrues xhamash, peceta pastrimi, shtupa dyshemeje, tel enesh, sfungjer enesh, thase plehrash; sgrasatore, dezinfektues tualeti, klor, sfungjer enesh, sfungjer trupi, lopate plehrash bisht dhe fshese, furce tualeti, fshese, kova, bishta fshese, shtupe pastrimi, peceta mikrofiber, qese mbeturinash, leter higjenike, letra te lagura, paste dhembesh, paste dhembesh per femije, furce dhembesh për femijë, ace, doreza pastrimi; acid për pastrim, anti kalkare per hidrosanitare, solucion kunder mizave, klor pluhur, ilac xhami, ilac pllakash, pulirapid, doreza, fshese, qese mbeturinash, leter higjenike, sfungjer enesh, shtupe mikrofiber; alkool dezinfektues, ace zbardhues, zbardhues blu, acid muratik; aromatizues, leter e lagur, kartopeceta, zhbllokues lavamani, peceta mikrofiber; kove me veteshtrydhje, kaci dhe bisht, kosha metalik zyre, maska njëpërdorimshe, aparat aromatizues ambienti, aparat leter duarsh; mastrolindo wc, fshesa pastrimi dhe bisht, sfungjer enesh, ilac xhami, qese plehrash te zeza, qese mbeturinash e mesme, furca tualeti, leter higjenike, sgrasatore purus; ilac xhami, antikalkare, kapse porte, leter higjenike, kosha rrobash, aromatizues ambienti, aparat aromatizues ambienti, bombul aparati, doreza pastrimi, pulirapid, fshesa pastrimi dhe bisht, kova pastrimi, qese mbeturinash 3 lloje, leter duarsh rulon; zbardhues blu, ilac xhami, xhel dezinfektues, alkool dezinfektues; klor rifuxho; lavapiati purus.

Komisioni gjykon, se krahasueshmëria e kontratave nëse janë të ngjashme, nuk ka të bëjë vetëm me natyrën e kontratës se ajo është një kontratë mallrash dhe ky fakt mjafton, por duhet parë në lidhje me zërat konkretë të mallrave të furnizuara. Në rastin konkret vetëm një sasi e pakonsiderueshme e zërave të faturave të paraqitura nga operatori ekonomik “Besim Kamberi” PF mund të konsiderohen të ngjashme me mallin objekt - prokurimi “*Pluhur larës për rroba larje me dorë (ambalazh qese plastike)*”. KPP gjykon, se eksperiencat e paraqitura nga operatori ekonomik “Besim Kamberi” PF nuk dëshmojnë se ky i fundit ka realizuar furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit në vlerën e kërkuar nga autoriteti kontraktor, duke mos krijuar kështu bindjen për realizimin me sukses të kësaj kontrate.

Pra Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se faturat e mësipërme të paraqitura nga operatori ekonomik ankimes në procedurën e prokurimit, nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit të kapacitetit teknik, për përvojat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes “Besim Kamberi” PF nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Besim Kamberi” PF, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-89010-11-24-2023, me objekt: “Blerje detergjent për rezervat materiale të Shtetit” me fond limit 4,040,943 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 11.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së mësipërme të prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Besim Kamberi” PF.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaïd Myzyri

